

VENDIM
Nr.444, datë 13.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.456, DATË 3.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURAT DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË
ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.456, datë 3.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr.1 të zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të planifikuara në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007” për rritjen e pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2007.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. 1

KLASA	KATEGORITE	PAGA MUJORE			
		PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZE)			SHTESA E POZICIO NIT
		<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore per Vjetersi (SHV)	Shtesa per Kualifikim (SHK)	Shtesa per Pozicion (SHP) leke
	I-a	10.050	2%	0	84.000
II	II-a	10.050	2%	0	65.000
II	II-b	10.050	2%	0	49.000
III	III-a	10.050	2%	0	37.450

